

INFRASTRUKTURA/ **PARKIMI****PARKIMI I BIÇIKLETËS DHE ZGJIDHJET E RUAJTJES****Vështrim**

Sistemet e vogla, të shpërndara të parkimit të biçikletave, të tilla si formë-U e përmbysur, lejojnë pedaluesit të parkojnë biçikletat dhe t'i lidhin ato për periudha të shkurtra dhe pranë destinacionit të tyre. Objekte më shumë të përpunuara dhe të sigurta për magazinim, të tilla si dollapët ose objektet e mbikqyrura, lejojnë pedaluesit të ruajnë biçikletat në mënyrë të sigurtë për periudha të gjata, në largësi pak më të mëdha se sa vendmbërritjet e tyre. Gama e produkteve në dispozicion shkon nga pajisjet e lira e të vogla për parkim deri në sisteme të automatizuara dhe të mbikqyrura.

Sfondi dhe Objektivat*Funksioni*

Sistemet e parkimit të biçikletave (mbajtëse, vend-qendrim) dhe objektet e magazinimit (dollapë, qendra të biçikletave) janë një sërë objektesh që lejojnë pedaluesit të parkojnë biçikletat e tyre në mënyrë të sigurtë, të përshtatshme dhe të rregullt. Si të tilla ato kontribuojnë për një hapësirë publike të mirë-organizuar dhe për të tërhequr më shumë biçikleta.

Qëllimi

Biçikletat mund të parkohen kudo, mbështetur ndaj një muri apo bashkangjitur një table apo një kangjelli.

Megjithatë, me një numër të madh biçikletash, situata bëhet e çrregullt dhe konfuze. Kjo nuk është më praktike dhe e sigurtë për pedaluesit, duke u kthyer në një problem fizik, vizual në hapësirën publike. Nga ana tjetër mund të dekurajojë përdorimin e biçikletës dhe ta kthejë mendësinë në të kundërt të pedaluesve.

Kudo është i pranishëm, i pritshëm apo i dëshiruar një vend për qendrimin e biçikletave të parkuara, duhet të vendoset me mirë-organizim, të jetë i përshtatshëm dhe objekt publik i sigurt. Kjo në vetvete do të nxisë përdorimin e biçikletës.

- Parkimi afatshkurtër i biçikletave, në-rrugë duhet të jetë i sigurt, i shpërndarë në hapësirën e rrugës dhe në sheshe. Këto duhet të jenë të pajisura me sistemet e parkimit të përshtatshme për të mbështetur dhe siguruar biçikletën.
- Për parkim afatgjatë dhe rritje të mbrojtjes kundër vjedhjes, duhet të sigurohen objektet e mbrojtura të magazinimit, të tilla si dollapë dhe qendrat e mbikqyrura të biçikletave. Këto mund të variojnë nga dollapët e vegjël individualë deri tek stacionet e mëdha të biçikletave.

Për më shumë informacion mbi objektet e magazinimit në lagje të rezervuar për banorët lokalë, shiko fletën e informimit mbi PARKIMIN E BIÇIKLETAVE, NË ZONAT E BANUARA.

Për më shumë informacion mbi planifikimin e sasisë, llojit dhe vendndodhjes së hapësirave të parkimit, shih fletën e informimit mbi PARKIMIN E BIÇIKLETAVE, NË QENDRËN E QYTETIT.

Për më shumë informacion mbi parkimin e biçikletave në vendqendrimet e transportit publik dhe stacione, shih fletën e informimit mbi SHËRBIMET E PEDALIMIT NË KRYQËZIMET ME DISNIVEL.

Zbatimi

Përkufizimi

Objektet publike të parkimit të biçikletave, përfshijnë dy lloje masash.

- Sistemet e parkimit të biçikletës janë struktura që mbështesin qendrimin vertikal të një biçiklete. Këto sisteme përfshijnë lloje të ndryshme të mbajtëseve dhe vend-qendrimeve për një biçikletë të vetme ose disa, me një sistem të integruar mbylljeje të rrufeshme apo jo. Ato lejojnë pedaluesin të parkojë biçikletën.
- Objektet e magazinimit të biçikletave janë hapësira të mbrojtura, ku përfshihen dollapët individual dhe ato kolektiv, si dhe qendrat e biçikletave. Ato mund të jenë të mbikqyrura apo jo, të automatizuara ose jo, me pagesë ose jo.

Sistemet e parkimit afatshkurtër

Pedaluesit, së pari duhet të jenë në gjendje të parkojnë biçikletat. Parkimi do të thotë lënia e biçikletës për një kohë të shkurtër, 2 orë ose më pak. Pedaluesit do të duan të parkojnë sa më afër të jetë e mundur destinacionit të tyre, zakonisht më pak se 50 m. Hulumtimet në qendrat e mëdha të qytetit në Mbretërinë e Bashkuar e ilustron këtë: pedaluesit u pyetën pse parkuan në një vend të caktuar, prej të cilëve 86% e pedaluesve thanë për shkak se ajo ishte afër destinacionit (vetëm 16% siguri), si dhe 75% e pedaluesve parkojnë për më pak se dy orë brenda 50 m nga destinacioni i tyre. Kjo kërkesë duhet të plotësohet me një ofertë të shpërndarë të shërbimeve të vogla të parkimit, në intervale të shkurtra të distancave.

Mënyra më e thjeshtë është ndarja e hapësirës së rezervuar për parkimin e biçikletës, pa instaluar një sistem parkimi. Kjo mund të bëhet thjeshtë duke shënuar, duke përdorur materiale të ndryshme të sipërfaqes ose duke përdorur aparatet e rrugës. Kjo nxit pedaluesit për të parkuar. Avantazhi është se hapësira lihet e lirë për përdorime të tjera, për shembull në sheshet e qytetit. Duhet theksuar se, është e përshtatshme vetëm për biçikleta që kanë vend-qendrimin e tyre dhe pajisjet bllokuese. Madje edhe atëherë, biçikleta nuk është e bashkangjitur në një objekt të caktuar dhe rreziqet për t'u rrëzuar, për t'u vjedhur apo sulmuar ekzistojnë.



Hapësira e lënë për parkimin e biçikletave, vetëm me shenja dhe me rrëmujën që e ndalon (Amsterdam, Holl)

Është e rekomanduar të realizohet një strukturë fikse që mbështet biçikletën, në të cilën ajo mund të jetë e bashkangjitur. Kjo strukturë fikse mund të marrë formën e një vendqendrimi, për një biçikletë të vetme ose një në secilën anë, por mund të jetë edhe një mbajtëse për biçikleta të shumta në një rresht.

Një gamë e gjerë produktesh është në dispozicion nëpër tregje, por jo të gjitha janë të një cilësie të mirë. Ndaj duhet të merren parasysh kriteret e mëposhtme në vlerësimin e cilësisë së produktit.

- A siguron stabilitet? Një biçikletë me 10 kg bagazh në një çantë anësore duhet të jetë në gjendje të qëndrojë drejtë pa u dëmtuar.



Jepi një Shtysë Pedalimit

Fletë Informimi për Zbatim

- A është e mbrojtur kundër vjedhjes? Struktura fikse duhet të sigurojë dy rrotat, të pasmen dhe përparme. Në qoftë se vetëm një rrotë është e bashkëngjitur, hajdutët mund të shpëpusin timonin. Nëse një biçikletë ka vetëm pajisjen bllokuese dhe nuk është e bashkëngjitur me sistemin e parkimit, hajdutët mund ta marrin biçikletën duke thyer bllokuesen.
- A është e përshtatshme me lloje të ndryshme biçikletash? Shumë sisteme të prezantuara për të akomoduar pirunin ose rrotën e përparme nuk mund të përshtaten me biçikletat e fëmijëve, biçikleta garash ose biçikleta popullore. Sistemet e varjes nuk janë të përshtatshme për biçikleta të gjata. Në disa situata mund të konsiderohen zgjidhjet e veçanta, të tilla si mbajtëse për biçikleta fëmijësh në shkolla.
- A është praktike? Sistemi duhet të jetë i lehtë për t'u përdorur, vetë-shpjegues dhe të kërkojë përpjekjet minimale. Pajisjet e sofistikuar të anti-vjedhjes mund të jenë të vështira dhe të ngatërrueshme për të vepruar. Çdo sistem që kërkon heqjen e biçikletës duhet të jetë më pak i përdorshëm.
- A është i fortë? Sistemi duhet të jetë i fiksuar në mënyrë solide me tokën apo murin, rezistent ndaj ndryshimeve të motit dhe ndaj kërcënimeve. Pjesë të vogla shpesh shërbejnë si leva për shkatërrim. Sistemet me pajisje bllokuese të tyre rrezikojnë mosfunksionimin ose dëmtimin nga kërcënuesit.
- A është e lehtë për t'u mirëmbajtur? Sistemi nuk duhet të mbledhë mbeturina dhe të jetë i lehtë për t'u pastruar, madje edhe kur është i pushtuar plotësisht nga biçikletat.

Në funksion të këtyre kërkesave, nuk është për t'u habitur se forma U-përmbysur është e rekomanduar gjerësisht. Lartësia është midis 0.7 m dhe 0.8 m. Trupi i biçikletës mbështetet ndaj saj dhe si trupi ashtu edhe rrota mund të jenë të bashkëngjitura me një dryn të vetëm. Është i lehtë për t'u përdorur dhe i përshtatshëm për të gjitha llojet e biçikletave. Dizajni është i thjeshtë, teknikë e ulët dhe i fuqishëm duke e bërë të lehtë për t'u instaluar dhe të vështirë për t'u shkatërruar. Ka kosto të lirë dhe kërkon mirëmbajtje minimale. Një pengesë horizontale shtesë është e dobishme për të mbështetur biçikletat e vogla. Për më tepër, çdo njëra prej tyre mund të jetë një linjë e thjeshtë dhe mund t'i vendoset një çati për mbulim. Gjithashtu lejon variacione të ndryshme projektimi që përshtaten me aparatura të rrugës.




Mbajtëse formë-U e përmbysur, me dizajne të ndryshme (MB burimi i imazhit: Cycling England)

Për të njëjtat arsye, mbërthyeset për rrotë të përparme, të ulëta duhet të shmangen. Këto mund të jenë fole prej betoni, mbërthyeset e ngjitura në një mur apo të përfshira në mbajtëse të biçikletës. Ato nuk japin qëndrueshmëri të mjaftueshme, kështu që biçikleta mund të bie dhe të dëmtohet, apo qoftë edhe nga një kërcënim. Gjithashtu nuk lejojnë që korniza të jetë e sigurtë. Së fundmi, mbajtëset mbledhin gjethe dhe mbeturina, si dhe kanë nevojë më shumë për

mirëmbajtje. Në Danimarkë, mbërthyeset për rrotën e përparme në formë-pyke janë përdorur gjerësisht dhe janë të rekomanduara, me kusht që mbërthyeset të jenë mjaft të gjera dhe të montuara në të njëjtën lartësi sa timoni i biçikletës. Por kanë ende disavantazhin që trupi nuk mund të sigurohet, ndaj nuk janë të rekomanduara në vendet ku vjedhja është një shqetësim i madh.




Mbështetëset me rrotë të parë horizontale DUHEN SHMANGUR (burimi i imazhit: T. Asperges)



Mbështetëse me rrotë të parë vertikale, në Danimarkë (burimi i imazhit: P. Celis 2008, Bicycle Parking Manua, DK)

Sistemet e biçikletave krijojnë hapësirë për inovacion dhe dizajn. Ato mund të bëhen objekte të çuditshme nëpër hapësira publike. Megjithatë kriteret bazë të cilësisë duhen respektuar gjithmonë.

Një shembull krijues është çelësi-biçikletë i zhvilluar në Odensa. Kjo është një pajisje elegante bllokimi e cila zhytet në tokë, kur nuk përdoret. Pedaluesi tërheq një vrimë gjilpëre që mund t'i bashkangjitet bllokueses së biçikletës. Vrima e gjilpërës është bashkuar me një tel dhe një peshë që e tërheq poshtë kur lëshohet. Avantazhi është se ajo nuk merr hapësirë dhe mund të përdoret me të gjitha llojet e biçikletave. Disavantazhi është se nuk ofron mbështetje për biçikletën: në Odensa ajo plotëson një mbajtëse biçikletash.




Çelësi biçikletë në Odense



Jepi një Shtysë Pedalimit

Fletë Informimi për Zbatim



Vendqendrimet e biçikletave si objekte dizajni, të forta, të qëndrueshme dhe të sigurta (David Byrne, New York)



Objektet afatgjata të magazinimit

Pedalesit gjithashtu kanë nevojë të ruajnë biçikletat e tyre. Ruajtje do të thotë lënie e biçikletës brenda një objekti me qasje të kufizuar dhe të mbuluar. Pedalesit do të kenë nevojë për parkimin afatgjatë, i cili mund të jetë për një orë apo më shumë, në një ditë të tërë, tërë natën ose disa ditë. Hulumtimi i Britanisë së Madhe i përmendur tashmë tregon se mbi 77% e udhëtimeve të njerëzve nga periferitë, bizneset apo arsimi, të cilët nuk ishin përgatitur të linin biçikletat e tyre për më shumë se dy orë, ishin të shqetësuar në lidhje me vjedhjet apo kërcënimet, por vetëm 55% udhëtimeve të njerëzve që dalin për pazare të shkurtra apo të argëtohen.¹

Kjo kërkesë mund të mbulohet nga një gamë e objekteve të sigurisë: dollapët individualë, kolektivë dhe dollapët e magazinimit të biçikletave në qendrat e mbikqyrura.

Dollapët individualë të biçikletave

Dollapët individualë të biçikletave janë përdorur në situata ku ka qenë e domosdoshme mbrojtja kundër vjedhjes së biçikletave dhe kërcënimeve, por edhe ku kërkesa është shumë e ulët për të krijuar një strukturë të mbikqyrur magazinimi (p.sh. stacionet hekurudhore të vogla, parqe & biçikletat pranë qendrave të qyteteve).


- Dollapët në vende publike zakonisht janë dhënë me qera privatisht për periudha nga një ditore deri në një vit. Përdoruesi është i identifikuar dhe merr një çelës unik. Ai paguan një parapagesë me vlerën e shtuar të sigurisë për një hapësirë e rezervuar. Dollapët lejojnë përdoruesit të ruajnë gjithashtu pajisje të tjera si helmetën, pompën, veshje të veçanta, etj. Disavantazhi është se hapësira e magazinimit nuk përdoret në mënyrë efikase, pasi ajo mbeten bosh për një pjesë të caktuar kohe.
- Dollapët mund të përdoren në mënyrë më fleksibile mbi bazën e shërbimit të së pari atij që vjen i pari. Ata mund të jenë të lirë: përdoruesit sjellin bllokuesit e tyre ose fusin një monedhë që do të mund ta tërheqin më pas. Lehtësisht kjo çon në abuzim: dollapët mund të jenë përdorur për të ruajtur gjëra të tjera apo monopolizuar. Ndryshe, përdoruesit paguajnë qeranë afat-shkurtër për të marrë një kyç ose një kod qasjeje. Kohët e fundit, dollapët elektronikë kanë bërë një tjetër paraqitje, në të cilin përdoruesit kanë një kartë smart dhe rezervojnë paraprakisht një dollap me kyç.
- Bllokuesit individuale janë më së shumti të lëvizshëm dhe mund të zhvendosen në vende të tjera. Nga ana tjetër, bllokuesit individualë janë të rëndë dhe zënë hapësirë shumë më tepër se parkimi jashtë dollapit. Kjo do të thotë se janë më të vështirë të integrohen fizikisht dhe estetikisht në hapësirën publike. Gjithashtu mund të kërkojnë një formë mbikqyrjeje dhe mirëmbajtjeje, mundësisht kontrolli nga kamera CCTV.
- Dollapët mund të menaxhohen nga autoritetet publike, një kompani e transportit publik, një agjenci parkimi apo ofrues privat.
- Çmimi themelor i një dollap individual me kyç shkon rreth 1000 .



Dollapë individualë në Bruzhe (BE)



Dollapë individual në stacionet e trenëve hollandezë NS Fiets



Dollapë elektronike, me kyçe elektronike prodhuar në San Françisko. Përdoruesit blejnë një kartë smart, që i lejon të hapin dollapët dhe t'i përdorin në çdo kohë.


Dollapët kolektive të biçikletave

Një dollap kolektiv biçikletash me kyç mund të përmbajë një numër biçikletash. Çdo përdorues paguan qerane dhe ka një çelës.

- Përparësia më e rëndësishme e dollapit kolektiv me kyç është se merr më pak hapësirë për të njëjtin numër biçikletash sesa dollapët individualë.
- Përdoruesit duhet të njohin dhe besojnë njëri-tjetrit. Magazini i biçikletave të fqinjëve është organizuar kryesisht në këtë mënyrë, si një hapësirë shtëpie magazinimi e ndarë nga një numër banorësh lokalë.
- Një përdorues mund të caktohet si mbikqyrës dhe person kontakti për organizimin menaxhues, për shembull në këmbim të një qeraje më të reduktuar.
- Dollapët kolektive mund të instalohen edhe në rrugë. Një shembull është 'daullja e biçikletës' e cila është përdorur shpesh në lagjet urbane (në Hollandë), ku nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të parkuar biçikletat jashtë rrugës. Kostoja e një daulle biçikletash me 10 vende parkimi biçikletash është rreth 5.000 .



Një daulle biçikletash



Dollapi karusel i biçikletave: biçikletat ndodhen në platformën rrotulluese që lëviz biçikletën drejt derës së hyrjes ballore (Suedi, shikoni klipin www.plugin.se)



Objektet e mbikqyrur për magazinimin e biçikletave

Një objekt i mbikqyrur për magazinimin e biçikletave mund të merret në konsideratë pothuajse në çdo qendër të qytetit dhe stacionin kryesor. Duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme.

- ☐ Një destinacion që tërheq numër të madh pedaluesish.
- ☐ Një pjesë e konsiderueshme e pedaluesve dëshiron të parkojë biçikletat e tyre për një periudhë prej më shumë se një orë.
- ☐ Rreziku i vjedhjes në këtë zonë është relativisht i lartë.

Disa rekomandime të mëtejshme.

- ☐ Lokalizimi i objektit është menduar që të shërbejë maksimumi 500 m nga destinacioni.
- ☐ Përdorimi i mundësive dhe hapësirave lokale që janë në dispozicion. Një qendër që pedalohet në shkallë më të madhe mund të jetë një ndërtim i ri. Por gjithashtu mund të jetë e vendosur jashtë në hapësira publike, mundësisht e mbuluar: kjo është shpesh më e dukshme, lehtësisht më e arritshme dhe më pak e shtrenjtë. Pajisjet e mbikqyrura të magazinimit mund të jenë më të dukshme edhe në ngjarje të caktuara, me sisteme biçikletash të rrethuara me pengesa të përkohshme.
- ☐ Konsiderojeni të lirë. Kjo sjell ndikim të fortë në zvoglimin e numrit të vjedhjeve dhe përdorimin e përgjithshëm të biçikletave.
- ☐ Zgjidhni një vend të njohur. Një cikël në ose pranë qendrës së qytetit apo një ndërtese historike do të thithet më lehtë në mendjet e pedaluesve.
- ☐ Bëjeni lehtësisht të arritshme. Niveli i tokës është më i preferuar. Magazinimi nëntokësor duhet të jetë i arritshëm nëpërmjet pjerrësisë dhe të projektohet me kujdes: gjerësia e hyrjes, ndriçimi.
- ☐ Të merret parasysh siguria sociale. Sigurohuni që hyrjet të jenë të dukshme dhe në vende me kontroll social të mjaftueshëm.

Mbikqyrja dhe automatizimi

Qasja e menaxhimit dhe mbikqyrjes mund të organizohet nga një personel i tërë, pjesërisht apo plotësisht i automatizuar.

- ☐ Mbikqyrja nga personeli në përgjithësi është vlerësuar nga përdoruesit. Personeli ka dikë që është përgjegjës në raste problemesh dhe kështu rrit sigurinë e perceptuar. Megjithatë, personeli është i kushtueshëm dhe zakonisht bëhet e mundshme vetëm për periudha të kufizuara, në mënyrë tipike nga ora 8:00 deri 18:00. Kjo kufizon përdorimin e objektit jashtë periudhave të pikut.
- ☐ Stafi shpesh është i mbështetur nga mbikqyrja pjesërisht e automatizuar. Kamera mbikqyrëse (CCTV) dhe sistemet elektronike të aksesueshmërisë lejojnë reduktimin e numrit të personelit dhe shpenzimet e shfrytëzimit.
- ☐ Teknologjia lejon qasjen dhe mbikqyrjen e papajisur dhe plotësisht të automatizuar, duke shmangur nevojën për personel. Kjo lejon 24-orë veprimtari. Në disa raste duhet kujdes i veçantë mbi sigurinë sociale: të luajë muzikë në çdo kohë, të lejojnë futjen e dritës brenda në mes të ditës dhe të ofrojnë pikëpamje nga rruga jashtë, të integrojnë funksionet pranë për 24-orë, të tilla si bar-restorante. Nëse objekti është perceptuar si i pasigurt, është më e udhës të mos përdoret.



Jepi një Shtysë Pedalimit

Fletë Informimi për Zbatim



Shërbime ruajtjeje të papajisur dhe plotësisht të automatizuar në stacione trenësh holandeze NS Fiets

Një zhvillim i kohëve të fundit është paraqitja e automatizuar plotësisht, në-rrugë e sistemeve të ruajtjes.

- Parimi është se biçikletat janë dorëzuar - kundrejt pagesës - një strukturë e cila pastaj automatikisht i parkon ato nëntokë.
- Dobia është se këta sisteme veprojnë në një bazë 24h dhe janë të sigurtë për biçikletat dhe pedaluesit. Në parim, ky lloj objekti i masave mbrojtëse të parkimit është 100% i sigurt kundër vjedhjes dhe kërcënimeve. Shpesh ka edhe hapësirë për helmetën tuaj dhe xhaketën. Në të njëjtën kohë, këto sisteme janë të arritshme në nivelin e rrugës, ku dhe mund të krijohen në mjaft vende të dukshme, me ndriçim të mirë gjatë natës.
- Disavantazhi është koha e nevojshme për të rimarrë biçikletën tuaj në nivelin e tokës. Në çdo sistem nuk zgjat më shumë se 35 sekonda për të rimarrë biçikletën tuaj, por në orët e pikut të trafikut ose të mbërritjes së trenit duhet të qëndroni në rradhë. Prandaj, numri i biçikletave duhet të kufizohet, nga 50 deri në 100.



Pema Biçikletë: 12 biçikleta varen nga rrota e tyre e përparme. Ruhet 30% e hapësirës.



Biceberg: parkim nëntokësor krejtësisht i automatizuar. Mund të ndahet në modulet prej 23, 46, 69 ose 92 biçikletave. Në Spanjë mund të gjenden tippet: www.biceberg.es



Fabrika e biçikletave në Hollandë: parkim nëntokësor për 200 biçikleta, në formë fabrike, 3m sipër tokës, 9 m poshtë. www.fietsmolen.nl



Sistemet Velominck dhe Velospace. www.Velominck.nl

Dimensionet themelore për parkimin e biçikletave

Rekomandimet për projektimin e hapësirave të parkimit për biçikleta standarde të rriturish.




- Sigurimi i një thellësie prej 2 m, me një minimum prej 1.8 m. Gjatësia standarde e biçikletave varion nga 1.8 m deri në 2 m.



Jepi një Shtysë Pedalimit

Fletë Informimi për Zbatim

- Sigurimi i një gjerësie prej 0.65 m. Kjo është distanca e nevojshme nga qendra-te-qendra ndërmjet biçikletave për të akomoduar gjerësinë standarde të timonëve, mes 50 deri në 65cm. Pastaj pedaluesit mund të parkojnë lehtë, pa u ngatërruar me timonët e biçikletave që do të parkohen. Nëse ka distancë, më të vogël, ndoshta vetëm një nga dy hapësirat do të përdoret. Në një distancë prej më shumë se 70 cm, mund të parkohet një biçikletë shtesë në mes, kur prurja është e shkurtër.
- Sigurimi i një rrugë përqasëse të lirë prej 1.8 m, për manovrime të lehta. Në objektet e mëdha të magazinimit, njerëzit kanë nevojë të parakalojnë njëri-tjetrin me biçikletat e tyre: rruga e përqasjes duhet 3 m deri 3.5m.
- Sigurimi i një hapësire më të gjerë për nevoja specifike. Në supermarkete apo në tregje, gjerësia duhet të rritet për të lejuar konsumatorët e ngarkuar me çantat e tyre të lëvizin me lehtësi. E njëjta gjë vlen për shërbimet pranë çerdheve dhe kopshteve, për prindërit me fëmijët. Nëse hapësira mungon, blerësit dhe prindërit do të jenë të detyruar të ngarkojnë ose jo, fëmijët në hapësirën e lëvizjes duke bllokuar pedaluesit e tjerë.
- Konsiderata për sistemet me kompaktësi të lartë-të ulët. Këtu, në mënyrë të alternuar biçikletat janë bërë përgjyesh në një nivel pak më të ndryshëm. Në këtë mënyrë, timonët nuk ngatërrohen dhe gjerësia nga qendra-në-qendër mund të reduktohet në 4 m (min. 0,375 m). Dallimi i nivelit duhet të jetë të paktën 0.25 m dhe lartësia e ngritjes nuk duhet të jetë më shumë se 0.35 m.
- Konsiderata për parkimin kompakt kënddrejtë. Kur biçikletat janë parkuar në një kënd 45°, timonët kanë më pak mundësi të ngatërrohen. Përveç kësaj, kjo zvogëlon thellësinë dhe hapësirën e nevojshme manovruese. Distanca nga qendra-në-qendër mund të reduktohet në 0.5 m (ose edhe 0.4 m) dhe thellësia në 1,4 m. Shqetësimi është se hapësira e parkimit mund të arrihen vetëm nga një drejtim.
- Lejimi i një hapësire standarde shfrytëzuese prej 1.8 m² për biçikletë. Kjo përfshin hapësirën e saj të parkimit (1.3 m²) dhe një rrugë të përbashkët për aksesim nga dy rreshta (0.5 m² për biçikletë). Kjo mund të ndryshojë nga rreth 1 m² për zgjidhje më kompakte deri në 3 m² me një gjerësi më të rehatshme prej 0.8 m.
- Përdorni vetëm parkimin me dy-rreshta si zgjidhje të fundit. Parkimi në dy nivele, një biçikletë mbi një tjetër, zvogëlon shfrytëzimin e hapësirës në mënyrë të konsiderueshme, deri në 50%. Në objektet shumë të mëdha të parkimit, kjo mund të jetë e pashmangshme për arsye të zvogëlimit të distancës për lëvizjen. Megjithatë, tërheqja e biçikletave kërkon një përpjekje serioze, që pedaluesit do të duan të shmangin. Përpjekjet mund të reduktohen duke fundosur rreshtin e poshtëm në një nivel më poshtë tokës dhe duke ofruar platforma të pjerrëta për rradhën e sipërme, ose duke siguruar mekanizma të tjera për tërheqjen.



Hapësira e fituar nga parkimi këndor

Udhëzime daneze për dimensionet e parkimeve për biçikleta (dimensionet pak të mëdha rekomandohen)



Sistem parkimi me dy-radhë



radhë më e zhytur dhe më e ulët



ose ulluqe për rrotat



Mbajtëse lart-poshtë

Konsiderata

Pikat e forta

Cilësi e mirë e sistemeve të parkimit dhe objekteve të magazinimit

- bën parkimin dhe ruajtjen e sigurtë të biçikletave, më të përshtatshëm dhe më të rregullt;



Jepi një Shtysë Pedalimit

Fletë Informimi për Zbatim

- përfshin produkte me kosto shumë efektive dhe që shfrytëzojnë më pak hapësirë, të tilla si mbajtëse formë-U të përmbysur
- përfshin zgjidhje të automatizuara, shumë të sigurta dhe reduktim të kostos së personelit

Pikat e dobëta

Cilësi e mirë e sistemeve të parkimit dhe objekteve të magazinimit

- mund të zënë hapësirë të konsiderueshme, sidomos dollapët individualë
- mund të jenë mjaft të shtrenjta për t'u instaluar, mirëmbajtur ose të dyja këto, sidomos kur është i përfshirë personeli i mbikqyrjes

Mundësitë alternative

Me një numër të madh biçikletash, nuk ka asnjë alternativë: asnjë shërbim për biçikletat nuk do të rezultojë si një hapësirë e rrëmujshme dhe me shumë gjasa të reduktojë përdorimin e biçikletave.